

VENDIM
Nr.854, datë 19.12.2003

PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E DREJTORISË SË AKREDITIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 dhe 14 të ligjit nr.9024, datë 6.3.2003 "Për akreditimin e laboratorëve testues, kalibrues, organizmave certifikuese dhe inspektuese në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e Drejtorisë së Akreditimit, si institucion me financim nga Buxheti i Shtetit, në varësi të Ministrit të Ekonomisë, e cila administron tërë sistemin e akreditimit në Republikën e Shqipërisë, si një institucion i pavarur dhe i paanshëm.

2. Drejtoria e Akreditimit të akreditojë subjektet e interesuara, private dhe publike, që kryejnë testim, kalibrim, inspektim, certifikim të produkteve, të sistemeve të menaxhimit të cilësisë dhe të mjedisit, të personelit, si dhe subjektet që kryejnë veprimtari të njëjta, të përcaktuara me akte ligjore. Ky institucion ua ofron këtë shërbim edhe subjekteve të huaja, jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë.

3. Drejtoria e Akreditimit harton rregulloren e vet të brendshme, që miratohet nga Ministri i Ekonomisë. Drejtori i Përgjithshëm raporton, periodikisht, te ministri, për ecurinë e punës.

Marrëdhëniet ndërmjet tyre rregullohen në bazë të urdhrave dhe udhëzimeve të Ministrit të Ekonomisë.

4. Subjektet e interesuara për këtë shërbim duhet t'i drejtohen Drejtorisë së Akreditimit me një kërkesë për akreditim, e cila bën vlerësimin e kësaj kërkesë në bazë të standardeve dhe të udhëzuesve të nxjerra nga organizmat ndërkombëtarë të akreditimit. Për kryerjen e vlerësimit të kërkesës Drejtoria e Akreditimit ngarkon specialistë, të cilët veprojnë në emër të këtij institucioni. Drejtoria e Akreditimit duhet t'i komunikojë kërkuarit vendimin e vlerësimit dhe t'i japë atij mundësinë për ta kundërshtuar atë. Vendimi i komunikohet edhe bordit të akreditimit. Drejtoria e Akreditimit i jep palës së interesuar të gjitha të dhënat e nevojshme për vlerësimin e kërkesës për akreditim.

5. Për të ndihmuar dhe mbështetur mbarëvajtjen e procedurave të akreditimit krijohet bordi këshillimor i akreditimit, i cili funksionon pranë Drejtorisë së Akreditimit. Bordi mbështet Drejtorinë e Akreditimit dhe autoritetet e tjera publike për çështjen e akreditimit. Anëtarët e bordit emërohen nga Ministri i Ekonomisë, për një periudhë 3-vjeçare dhe jo më shumë se dy herë radhazi. Numri i anëtarëve të bordit është 11 veta. Anëtarët janë përfaqësues të Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, Ministrisë së Shëndetësisë, Ministrisë së Mjedisit, Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë, Universitetit Politeknik, Fakultetit të Shkencave të Natyrës, Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimit.

Drejtorja e Akreditimit ka përgjegjësi për organizimin e punës dhe për realizimin e detyrave të bordit të akreditimit.

Rregullimi i veprimtarisë së bordit bëhet me rregullore të brendshme, e cila miratohet nga Ministri i Ekonomisë. Bordi këshillimor mblidhet jo më shumë se një herë në muaj. Anëtarët e bordit shpërblehen me 3 000 (tre mijë) lekë për çdo mbledhje.

6. Në rastet e veçanta, për ndjekjen e procedurave të akreditimit, kur nga Drejtoria e Akreditimit vlerësohet e nevojshme, krijohen komitete teknike, të përbëra nga specialistë të fushave të caktuara, të cilët hartojnë kërkesat e veçanta për akreditim në fushat përkatëse. Ata emërohen nga Ministri i Ekonomisë me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Akreditimit. Shpërblimi i tyre përcaktohet nga Ministri i Financave.

7. Akreditimi është i vlefshëm për katër vjet. Drejtoria e Akreditimit i lëshon kërkuarit certifikatën e akreditimit, e cila përmban emrin dhe adresën e organizmit të akredituar, fushën e akreditimit, standardin ose udhëzuesin e përdorur për vlerësim dhe vlefshmërinë e akreditimit. Riakreditimi mund të sigurohet pas një rivlerësimi të plotë. Subjektet e akredituara kanë të drejtë të përdorin stemën e akreditimit, në përputhje me procedurat e veçanta të Drejtorisë së Akreditimit.

8. Drejtoria e Akreditimit, gjatë periudhës së vlefshmërisë së akreditimit, mbikëqyr statusin e akreditimit. Për organizmat e vlerësimit të konformitetit, mbikëqyrja e akreditimit organizohet nga Drejtoria e Akreditimit, kur organet përkatëse kryejnë kontrollet periodike të vlerësimit të statusit të autorizimit. Subjekti i akredituar duhet të sigurojë vazhdimësinë e plotësimit të kushteve të akreditimit. Ai duhet të njoftojë, brenda 1 muaji, Drejtorinë e Akreditimit për çdo ndryshim të rëndësishëm, i cili mund të cenojë plotësimin e kushteve të akreditimit.

9. Drejtoria e Akreditimit, kur kushtet e akreditimit nuk plotësohen, ka të drejtë ta pezullojë ose ta tërheqë akreditimin. Në rastet e moskonformiteteve në shkallë të ulët, ku si të tilla vlerësohen ato që nuk cenojnë vlefshmërinë e akreditimit, Drejtoria e Akreditimit mund t'i ngarkojë detyra shtesë organizmit deri në plotësimin e kushteve .

10. Në rast pezullimi të autorizimit të organizmave të vlerësimit të konformitetit Drejtoria e Akreditimit njoftohet nga organet përkatëse për të kryer vlerësimin e kushteve të akreditimit.

11. Drejtoria e Akreditimit u jep të dhëna subjekteve të interesuara, publike ose private:

- për parimet, kushtet, procedurat dhe tarifat e akreditimit;
- për subjektet e akredituara në Republikën e Shqipërisë;
- për adresat e organizmave të huaja të akreditimit.

12. Drejtoria e Akreditimit, për kryerjen e detyrave të parashikuara në ligj, bashkëpunon me institucionet publike dhe subjektet private, vendase ose të huaja, si dhe merr pjesë në veprimtarinë e saj.

13. Kreu III i vendimit nr. 371, datë 4.8.1999 të Këshillit të Ministrave "Për kriteret dhe kompetencat në fushën e standardizimit, certifikimit dhe akreditimit", shfuqizohet.

14. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano